



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.739/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj dhe Adnan Konushevci anëtar duke vendosur përkitazi me apelin e Kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Ardison Hoxha, si votues në Komunën e Drenasit, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2948/2021 i datës 03.11.2021, për shpalljen e Rezultateve përfundimtare për zgjedhjet Lokale 2021.Per Kuvendin Komunal në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021.mori këtë.

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.739/2021 i datës 03.11.2021, i ushtruar nga Ardison Hoxha si votues ne komunën e Drenasit .

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtar të kuvendit kumunal në komunën e Drenasit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega ne Komunën e Drenasit në vendvotimet 0310e/01R, 0310e/02R ,0310e/03D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 03.11.2021, nga kandidati per anëtar te kuvendit komunal në komunën e Drenasit Ardison Hoxha, nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK), me të cilën pretendon se ai dhe familja e tijë dhe rrethi i shoqrisë kanë votuar për kandidatin për asamble Komunale Përparim Shala dhe të njetit nuk i kanë dalë votat në formularet dhe po ashtu ju kanë prishur rreth 30 vota. Në këtë vendvotim del se rezultati është 00, se kandidati nuk ka asnjë votë në këtë klasë, pra kandidati është dëmtuar me 7 vota. Më tej ka cekur emrat e disa dëshmitarëve si dhe provën materiale si kopjen e formularit të publikuar në faqe të KQZ-së dhe fletë plotësimin e kordinatorit të shkollës në këtë vendvotim.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli, me datë 05.11.2021, në përbërje të ekipit hetues të PZAP-it, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që nga fletvotimet e vlefshme kandidati me nr 5 Përparim Shala ka 7 vota ndërsa ne FRK i shkruan se i ka 6 vota. Nga fletvotimet e Pavleshme Kandidati nr 5 e ka te shënuar Subjektin politik. Nga hetimi i materialit zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutinë e Votimit 0310E/01 R, 0310e/02R,0310e/03D konstaton se në formularin e rezultateve për kandidatë FRK, kandidati me nr.5 Perparim Shala ka zero (0) vota, ndërsa pas numërimit të votave në fletëvotimeve, kandidati Perparim Shala ka gjithsej 7 vota të vlefshme dhe ne fletëvotimet e pavlefshme kandidati nr 5 e ka te shënuar numrin mirëpo nuk e ka te shënuar subjektin politik..

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatet për asamble komunale nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në vendvotimin e lartcekur, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashfresa

Anr. 739/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuesi i Panelit
Zyldi Haziri

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.